

AGIM HUSHI
UDHA E QUMËSHITIT
TREGIME

BOTIMET TOENA

AGIM HUSHI

UDHA E QUMËSHTIT

tregime

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-327-37-6

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

PARATHËNIE

Shkrimtari jo rrallëherë gjendet përpara dilemës krijuese:
“Të shkruash, a të mos shkruash?!”

Megjithatë, kjo mëdyshje nuk vlen për ata më të talentuarit, për ata që e kanë “hambarin” e përvojës jetësore plot, të cilët krijimtarinë artistike e kanë jo vetëm një ndër dimensionet e personalitetit, por edhe një nga misionet e jetës së tyre. Vullneti qëndron tek ata krijues, të cilët guxojnë të rrëfejnë vizionin e tyre e që besojnë se ka ligje dhe energji të mjaftueshme për transformimin e shoqërisë, duke perfeksionuar e përmirësuar gjithë sistemin e vlerave humane. Nëse një krijues nuk udhëhiqet nga motive të tilla idealiste, në veprat e tij do të ketë, pa dyshim, “kërcitje” nga lënda e materies. Për fat të mirë, apo të keq, qëllimi kundrejt pragmatizmit për individin e sotëm është kthyer në një filozofi jetike. Te kapitali, si doktrinë, konvergojnë dhe vërtiten tërë aksiomat dhe idetë, aty janë orientuar pothuajse gjithë sensorët e shoqërisë njerëzore.

Teksa lexova me ëndje vëllimin me prozë të shkurtër, me titullin kozmik “Udha e Qumështit”, të poetit Agim Hushi, jo thjesht u mrekullova, por njëkohësisht dhe u freskova në këtë zheg korriku, u freskova me tematikën e larmishme të përzgjedhjes për t’ia sjellë përpara lexuesit.

Fati im të kem në dorë këtë libër dhe të jem nga të parët lexues që “degustoj” këtë koktej ngjyrash, ndjenjash, udhëtimesh, të sjella me mjeshtëri nga përvojat e çmuara, në etapa të ndryshme të moshës së autorit. Ngjarjet vijnë të përshkruara, nëpërmjet një verbi të bukur rrëfimtar, të spikatur dhe modern, pa predikime, moralizime dhe mesazhe të drejtpërdrejta. Lojën e bëjnë personazhet, autori rrëfen duke ruajtur me kujdes statusin si asnjans, e më tej duke shpalosur çastet më mbresëlënëse e më të papërsëritshme të jetës së tij.

Jam i sigurt se një thesar i tillë shpirtëror do të bënte ziliqar çdo poet, ose shkrimtar, madje çdo eksplorator të pasionuar, pas aventurave për udhëtime të gjata e me plot surpriza.

Natyrisht që një komoditet të tillë nuk e ka gjithkush. E cilësova “komoditet” edhe pse nuk është i tillë, përveçse fryt i një pune titanike, i një durimi gati mitik, për të arritur në majat e artit, pikërisht aty ku gjendet sot poeti, prozatori, piktori, akademiku dhe tenori me famë botërore, Agim Hushi.

Nuk e teproj aspak nëse individualitetin e tij e cilësoj si një diamant të çmuar, i cili u zbulua së pari në këtë vend dhe i përket deri në krenari po kësaj toke që quhet Shqipëri.

Autori shkon e vjen natyrshëm nga skaji në skaj, ku pavarësisht amplitudave të jetës, sukseseve të arritura, ai nuk mohon aspak rolin e vendlindjes për formimin e tij bazik si qytetar dhe si artist.

Qyteti i vogël, është pikënisja e ëndrrave, e konvertuar në vargje dhe vokalica, për të ardhur deri këtu, në majat

triumfuese, gati të pabesueshme, të auditorëve dhe skenave botërore.

Pa një jetë aktive, gjithmonë në lëvizje të autorit, në këto tregime do të na mungonte larmia e fakteve, karaktereve dhe motiveve, e mbi të gjitha do të na mungonte filozofia njerëzore, që me përzgjedhjen e kujdesshme të tematikës, së bashku me radhitjen e ngjarjeve në kohë, ravijëzon tamam si në një “puzzle”, portretin e saj.

Shkrimtari nuk trillon, ai i njeh thellësisht të dyja ekstremet e jetës, që nga fëmija i braktisur e deri tek “Udha e Qumështit” në Malajzi, ku të lë të kuptosh se uria e popujve nuk mund të shuhet me një apo me dy vakte të dhuruara, por do zgjidhje madhore. Pastaj autori, si për të mbushur boshllëkun shpirtëror të lexuesit, shenjtëron edhe më tepër natën e falënderimeve të “Darka e shenjtë”, duke ngjallur shpresën e duke shuar urinë e Sofisë dhe dy fëmijëve të saj në një tryezë të bollshme. Përsëri të fut në mendime se hallet e njerëzimit nuk zgjidhen me magji. Shkrimtari e ka në dorë situatën dhe me një të rënë të lapsit mund ta ndryshojë rrjedhën e subjektit, por ai nuk e bën këtë sepse nuk i shmanget problematikës. Krijimtaria e çdo autori të njeh me opinionet dhe mendimet që ka ai kundrejt fenomeneve sociale, por në të njëjtën kohë krijimtaria shpalos dhe karakterin e tij. Agim Hushi me zgjidhjen që u jep rrëfimeve shfaq botën e tij të madhe dhe të ndjeshme. Të kreshpëron tregimi “E përdala” që zbulon instinktet e paskrupullta të turmës dhe të rrëqeth të tragjedia “Dy vëllezërit”. Dhe kapërcimet vazhdojnë me kontrastet e thella, që lindin nga njëri tregim, tek tjetri. “Profesori”, simboli i dijes, ai që sa e sa fëmijëve u

ndriçon mendjen, pse jo u ndryshon edhe fatin, pikërisht ky njeri ndihet i braktisur dhe i harruar; merr një pagë gjysmake që e detyron të zgjidhë urinë në kazanin e plehrave.

Autori nuk ka për qëllim thjesht të tregojë bëma dhe gjëma, por të sjellë argumente të pakundërshtueshme pse jemi katandisur kështu. Ai sjell dramën e jetës, që në çdo çast merr përmasat e një tragjedie për brezin e ri, ku mendja fluturon ndër ëndrra dhe dëshira, ndërsa këmbët janë në llumin e varfërisë dhe injorancës. Si të mos mjaftonte kjo autori trajton një temë edhe më të guximshme, atë të kalbjes së sistemit shoqëror, pikërisht atje në krye të tij. Marrëdhëniet midis njerëzve nuk janë aq humane, diçka i provokon rëndë ato. Ajo që më befason është se autori di të bëjë diferencimin e temave, pasi Shqipëria dhe vendet e qytetëruara nuk kanë të njëjtat halle. Nga uria e fëmijëve, nëpër metropole dhe zona rurale, te “Mbretëresha”, që jeton në luks. Jeta mondane e monarkes së plakur, e cila dremit dhe kërkon paqen mbi qefinin e një kohe që po perëndon. Përfundimi në çdo rast vjen natyrshëm.

Po autori nuk do të ndalet as këtu. Në një tjetër çast ai e çon lexuesin të udhëtojë bashkë me të, me avion drejt Sidneit e në një tjetër moment zbret në Moskë e niset me tren për “Një takim në stepë” drejt Siberisë. Me shtegtimin për në Polin e Jugut, përshkruan shpirtin njerëzor deri në dhimbje, te “Shtëpia e engjëjve” aty në sediljet e vendosura pranë dritares së avionit takon personazhin më interesant, murgun budist, një krijesë “e fortë”, pjellë e mëkatit, i cili transformohet në një qenie e brishtë e mishërimit të mirësisë. E në Polin e Veriut, heroji lirik, zbulon “vëllanë”

e burrëruar me një peng të madh në zemër, “produkt” i një sistemi kriminal, që mbi çdo gjë, e mbi gjithçka vendos dogmën e një filozofie utopike.

Barbaria sintetizohet qartazi deri në ekstremitet, te tregimi “Pata e artë”. Një rrëfim jetësor, që e sjell thjesht me naivitetin e një krijese delikate, siç është fëmija, duke përcjellë natyrshëm gjendjen e degraduar sociale të një shoqërie që vret deri në qelizë ndjenjën latente, besimin e natyrshëm dhe lirinë sublime të fëmijëve, duke e nxjerrë lakuriq atë kohë, plot slogane dhe dogma, e cila në emër “të shumicës” degradoi personalitetin e njeriut, shkatërroi boshtin themelor të vetë arsyes, për hir të së cilës dhe jemi në këtë jetë.

“Pata e artë”, në harkun kohor sa hap e mbyll sytë, kryen fluturimin tragjik, duke përcjellë natyrshëm mesazhin se një shoqëri që nuk respekton dëshirat e fëmijëve, herët a vonë, është e destinuar të shembet.

Por vektori i krijimtarisë së shkrimtarit përsëri lëviz me shpejtësi, në një rreze të gjerë në hapësirë dhe në kohë, ai në çdo rast mban për seli shpirtërore vendlindjen, atë qytetin e vogël rrëzë kodrave të ulëta në breg të Adriatikut. Aty bën një retrospektivë romantike, me “cicmicet” e dashurisë në adoleshencë, pasi për Agimin, nuk ka tema të mëdha apo të vogla, për të ka qëllime të shprehura me art, në funksion të mesazhit social. “Shtriga” e bukur, me ndjenjën mbisunduese, që me një egoizëm femëror ndan të sapodashuarit, të bën të vësh buzën në gaz e ta duash më fort. Është një psikologji e tërë që duhet të merret me këtë fushë. Ndonjëherë, surpriza të befason me rastësitë e saj e të

bën të dyshosh, si mundet të ndodhë kështu?! Te “Maskat e Romës”, “Udhëtim për në stepë”, edhe vetë autori e kupton këtë, por gjithçka kryet në funksion të asaj çka duhet thënë. Apo “Ullishta” që fshehu dhe zbuloi njëherësh surprizën e padëshiruar të djelmohave. Mësuesja e tyre e bukur, idhulli i ëndrrave të tyre, etaloni me të cilin ata do të matnin bashkëshortet e ardhshme, na dashuruaka dikë?! “Ullishta”, pa dyshim, përgjithëson aq bukur ndjenjat e asaj moshe, ku zhgënjimi lë vrage në shpirt, e cila zbehet vetëm kur personazhet rriten.

Papritur autori si një shtërg i bindur shtegton përsëri, por këtë radhë në Europë. “Maskat e Romës” një nga tregimet më tronditëse. Simoni, ky personazh me tipare tejet njerëzore, i cili beson verbërisht në virtytet e gruas së tij, shokohet pikërisht në atë moment kur dhe vetë tundohej të kryente aktin e parë të tradhtisë bashkëshortore. Ai kuptoi se tradhtia paskësh qenë e ulur këmbëkryq në vatër me kohë, por shpeshherë i zoti e merr vesh i fundit. Kjo ngjarje mund të sillte goditjen fatale për familjen, po çuditërisht godina e saj nuk u shemb, por qëndroi më këmbë, pasi hyri në lojë gjykimi dhe arsyeja, e ardhmja e fëmijëve, mbi të cilët nuk qëndron asgjë.

“Maskat”, simbol i hipokrizisë njerëzore. Ato askush nuk guxon t’i heqë, pasi tashmë ato për qytetërimin janë bërë tabu. Nëse guxojmë t’i prekim, atëherë do t’i ndiejmë deri në palcë tërmetet sociale.

Autori herë pas here kthehet dhe trazon kujtimet, të cilat i rrëfen me një butësi të admirueshme, e pastaj si bën një tango të bukur së bashku me avionin “Çesna”, “degdiset”

te “Fillimi i botës”, aty për aty zbret në tokë e vallëzon me aborigjenët, të cilët ruajnë ende në shpirt zakonet e moçme, raportet arkaike, por tejet të besueshme të njeriut me zotat dhe me mëmën natyrë.

Ajo çka të trishton pasi ke mbaruar leximin, është braktisja deri në harresë të plotë e këtyre njerëzve, ndërsa ajo çka më mahnit se tepërmi, janë detajet e dhëna për pilotin, për shpirtin e tij të aventurës.

Një përshkrim gati personifikues i avionit “Çesna”, që çante qiellin dhe dukej sikur për karburant përdorte merakun dhe dashurinë e pakufishme të Berrit. Vërtet ky është udhëtimi më magjik i kryer ndonjëherë, por nga rrëfimi, në rrëfim mbizotërojnë kontrastet e thella.

Tregimi që të sëmbon në zemër është “Armiku”. Një subjekt i papërsëritshëm, me një mesazh të madh. Historia e tmerrshme e luftës së klasave, shpëlarja e trurit, ku njeriu urren njeriun, ku mendja halucinante, pasi zgjohet, kupton rrethin vicioz të barbarisë që ka kryer. Ndërgjegjja nuk ka më paqe dhe kërkon drejtësinë dhe faljen e madhe, të cilat i lyp si një çelës, që duket sikur nuk kanë asnjë vlerë tjetër, veç për të hapur portën e botës së përtejme.

Këto rrëfime, me të gjitha elementet e një proze klasike, diku më shfaqen si prozë poetike, madje vijnë si një poezi me varg të bardhë. “Dreri” bart një mesazh universal edhe pse duket një subjekt gati si një përrallë. Zbritja me një trajektore në kohën e luftës shekullore për liri te “Nata e fundit”, stoicizmi epik i personazhit Jaho, të lë mbresa të pashlyera në kujtesë. Proza e shkurtër përgjithësisht kërkon fabul, këtu kam parasysh tregimet e Mopasanit, Çehovit, apo

Elin Pelinit, pse jo dhe të Dino Buxatit, por te ky libër nuk ka trill, as “surpriza” të sajuara me stil, me qëllimin e vetëm për të mbajtur në ankth lexuesin. Tek “Udha e Qumështit” do të gjeni jetë dhe vetëm jetë, të shprehur pa pompozitetin e një letrari të madh. Vëllimin e përshkon fund e krye si një fill i kuq, gjuha e thjeshtë deri në modesti e autorit, që mund të vinte edhe në formën e ditarit, por autori me ndërgjegje ka zgjedhur këtë gjini artistike, pasi këtu galeria e personazheve të tij, me simbolikën e përgjithësimit, merr gjithë vëmendjen e lexuesit. Një nga një tregimet ngjajnë si substancat e një tharmi, nga ku mundet të zinin fill rrëfime më të gjera, në nivele novelash apo romanesh, por autori e njeh mirë psikologjinë sociale të shoqërisë së konsumit, e cila është e prirë drejt esencës dhe i do gjërat t’i rrufisë “flesh”.

Me këto impresione, që po marr nga këto tregime, i garantoj sukses të sigurt librit “Udha e Qumështit”, duke shpresuar që së shpejti krijimtaria e poetit Agim Hushi, përpos poezisë dhe tregimit, të kulmojë me romanin e tij të parë!

Një fillim i mbarë të çon gjithmonë drejt majave dhe këtë më mirë se çdokush tjetër e di poeti Agim Hushi.

Ymer Nurka

DARKA E SHENJTË

Pa dyshim kjo është ngjarja më e rrallë, më e çuditshme që ju ka rastisur të dëgjoni!

Ka ndodhur në një qytet të largët e të vogël të Amerikës dhe ka tronditur të madh e të vogël!

Jo vetëm i ka çuditur skeptikët, por edhe i ka bindur ata se engjëjt ekzistojnë!

Se ata janë pranë dhe midis njerëzve!

Sofia jetonte e vetme me dy djemtë e saj, dhjetë dhe tetë vjeç; Samuelin dhe Xhonin. Të dy ishin fëmijë të mrekullueshëm, të zgjuar, me flokë të artë. Sofia ishte krenare me djemtë e saj. I shoqi e kishte braktisur për një grua tjetër para tri vitesh.

Por para një viti ai kishte pësuar një aksident në punë dhe kishte vdekur duke e lënë Sofinë fare të vetme, por dhe pa pensionin e fëmijëve.

Sofisë i ishte dashur t'i dilte vetë zot djemve të saj.

Jetonin në një shtëpi fare të vogël, të tre flinin në një dhomë të vetme.

Sa më shumë varfëroheshin, aq më shumë Sofinë e lumturonin djemtë që po rriteshin të mbarë.

E dëgjonin dhe e ndihmonin pothuajse për çdo gjë në shtëpi.

Nuk kaloi shumë kohë dhe Sofinë e pushuan nga puna.

Për të erdhi një situatë e tmerrshme.

Me ndihmën, që merrte nga shteti, mezi e paguante qiranë. Të mos mendojmë që duhet të ushqeheshin, të paguanin dritat dhe ujin e të visheshin.

Sofia përpiqej t'ua fshihte mjerimin e tyre fëmijëve, që gjithsesi e kuptonin se ishte një përpjekje e pafat dhe e përditshme që të jetonin.

Por një ditë ishte shumë më e trishtueshme për ata.

Nata e “thanks giving” ishte një natë e shenjtë, ku të gjithë shtronin tryezat me gjel deti, ëmbëlsira dhe gëzoheshin. Ishte një natë e shenjtë e bollëkut dhe e mirësisë, ku asnjeri nuk duhej të flinte i uritur.

Por Sofia nuk kishte të holla.

E therte në shpirt kjo natë që me bollëkun e saj, i dukej aq e largët.

I mori djemtë, që nuk po ankoheshin fare, në gjirin e saj. Ishte e bekuar që i kishte aq të mirë!

Jashtë nata kishte shtruar me ngadalë palat e dëborës së bardhë. Sa keq që dëbora vjen me mjerimin, mendoi dhe i shtrëngo i më fort rreth vetes dy djemtë e saj! Mallkoi veten dhe fatin për këtë mjerim!

- Do t'ju blej nga një hamburger MacDonald, - i tha ajo djemve si për t'i lumturuar.

Por ata nuk iu përgjigjën. E dinin sa e vështirë ishte kjo për të ëmën.

Tak, tak-tak gjëmoi dera.

Kush mund të jetë kaq papritur në këtë kohë, mendoi Sofia!

E hapi derën me vrull dhe shtangu.

Përpara saj qëndronte një plakë me pamje hyjnore.

E bukur, e hijshme me flokë të artë.

Kishte një mirësi marramendëse në paraqitjen e saj.

- Më falni, - tha plaka. - Por jam këtu për ju. Jeni të ftuar në shtëpinë time. Sonte është “thanks giving”. Ju lutem mos ma prishni, - tha ajo. - Unë jam e vetme dhe do të më lumturonit shumë që sonte ta ndajmë ushqimin bashkë. Unë jam fqinja juaj.

Plaka u shfaq si me magji, në kulmim e dëshpërimit të Sofisë kur s’kish asgjë çfarë t’u jepte djemve për darkë!

- Shumë faleminderit! - iu përgjigj Sofia. - Por është e tepërt!

- Jo, jo, aspak, - këmbënguli plaka. - Është kënaqësi për mua të jemi bashkë.

Sofia nuk e zgjati.

Mori dy djemtë dhe shoqëroi plakën. Nuk vonuan dhe arritën në apartamentit e plakës që shkëlqente i gjithi nga dritat dhe pastërtia.

Tryeza ishte e shtruar plot, me gjithë të mirat. Në mes qëndronte gjeldeti i pjekur. Ëmbëlsirat dhe frutat të verbonin!

Hëngrën shumë aq sa nuk kishin ngrënë kurrë në jetën e tyre.

Plaka ndriçonte me mirësinë dhe fisnikërinë e saj, megjithëse nuk fliste, por gjatë gjithë mbrëmjes i shërbeu djemve dhe Sofisë! Vetë hëngri shumë pak, por gëzohej që ata po hanin të lumtur.

Vonë, pasi darka mbaroi, ata u ngritën dhe e përqaftuan plakën zemërmirë.

U ndjenë aq mirë sa nuk ishin ndier kurrë! Atë natë i zuri gjumi me barkun plot dhe panë ëndrra të bukura. Fjetën të lumtur me mirënjohjen në zemër për plakën e mirë!

Të nesërmen kur u zgjuan e ndienin veten të ngopur.

- Djema, po shkoj vetëm një minutë ta falënderoj për mikpritjen e saj! - tha Sofia dhe doli të takonte plakën që i priti aq mirë.

Zbriti në katin më poshtë dhe u drejtua nga apartamenti i plakës.

Trokiti në derë disa herë, por s'iu përgjigj askush.

U tremb dhe pothuajse u tmerrua kur hodhi sytë pas dritares dhe pa shtëpinë e boshatisur. Një shtëpi që, shkëlqente e gjitha një natë më parë, tani ishte e shkretë! S'mund t'i besonte syve!

“Kjo është e pamundur!”, i foli vetes me zë të lartë.

Mori rrugën tek apartamenti i kujdestarit të pallatit. Pas disa trokitjeve kujdestari u shfaq në derë.

- Më falni, - foli si e hutuar Sofia.

E pyeti menjëherë për plakën, por kujdestari shqeu sytë i çuditur.

- S'ka mundësi, - belbëzoi ajo e çuditur tej mase.

- Ajo ka një vit që ka vdekur. Shtëpia është e mbyllur që prej një viti.

- E pamundur! - belbëzoi Sofia. - Unë isha mbrëmë. Kemi ngrënë bashkë.

Sofia u trondit. Kjo ishte jashtë çdo lloj imagjinate! S'mund ta besonte kurrë këtë që kishte ndodhur! Aq më tepër që nuk besonte kurrë në besëtytni.

Por në fund sikur u qetësua.

Ndoshta kjo ishte mrekullia e mjerimit. Apo mrekullia e mirësisë. S'deshi ta mendonte më gjatë se si ndodhi mrekullia e mbrëmshme. Kush e kishte bërë dhe ç'kishte ndodhur.

I tregoi djemve për ndodhinë dhe ndjeu lotët t'i binin syve. Lot për atë plakë të mirë që rrëzëlleu me mirësinë e saj sa bota.

TAKIM NË STEPË

Avioni u ul me një vrull jo të zakonshëm në aeroportin e Moskës, të mbuluar dhe të zbardhur nga bora.

Betoni i ngrirë sikur e kthente frenimin e avionëve në një vallëzim mjellmash në pistën e akullit!

Ernesti sapo vuri këmbën në shkallaren e hekurt të aeroportit, ndjeu erën e akullit t'ia priste fytyrën. Mbuloi shpejt dhe me kujdes, me shallin e madh e të leshtë, qafën e zbuluar dhe u kujtua se kishte ardhur në një nga vendet më të ftohta të botës së qytetëruar për të kënduar.

Ishte hera e parë që vinte në Moskë.

Ishte ftuar të këndonte në një festival botëror të operës, që mbahej diku larg në Republikën Çuvashe, në Çeboksari.

Më pas, në kthim, do të këndonte në teatrin “Balshoi” të Moskës në një koncert të madh Gala, me këngëtarët më të mirë rusë, ku, siç e kishin njoftuar, ai do të hapte dhe mbyllte koncertin me ariet e tij.

Ndihej i lumtur që do vizitonte këtë vend të madh, me kulturë të madhe, ku kishin jetuar dhe krijuar artistët e tij të preferuar: Pushkini, Çehovi, Tolstoi, Kuprini, Esenini, Glinka, Rahmaninovi, Çajkovski...

Pasi kaloi kontrollin rutinë të kufirit, në hollin e aeroportit e priste Madamë Karpova me një tufë lule në duar, ku shkruhej emri i tij.

U ndje keq për një moment që një zonjë po e priste me lule.

Mirë se vjen në Moskë e uroi dhe e përqafoi ajo gjithë dashuri duke e puthur lehtë në faqe!

- Si të shkoi udhëtimi? - e pyeti Madamë Karpova me një anglishte të pastër, pa atë aksentin e njohur rus.

- Mirë, faleminderit, - iu përgjigj Ernesti i mahnitur nga paraqitja e hijshme e Ludmillës, që menaxheri e kishte porositur ta thërriste Madamë Karpova. Dikur ajo kishte qenë një yll i operës, një soprano e njohur në botë, tashmë në pension.

Flokët e artë, kuruar me kujdes, sytë blu të thellë dhe ato buzë të skuqura nga të ftohtit, bashkë me lëkurën e lëmuar si mëndafsh i bardhë, i jepnin asaj një pamje magjepsëse.

Eh, rënkoi gati me vete! Jo më kot në këtë vend janë krijuar disa nga kryeveprat e botës. Bukuri të tilla janë muza të vërteta, mendoj gati me trishtim.

U futën në një makinë “Mercedes” të argjendtë dhe Ernesti ndjeu ngrohtësinë e një mjedisi të përgatitur me kujdes.

Po errej dhe makina po çante rrugën e akullt me shpejtësi.

Befas sytë i ndeshën ca drurë të mëdhenj në ngjyrë të zezë, të kryqëzuar.

- Kanë mbetur këtu që nga Lufta e Dytë Botërore, - i shpjegoi Madamë Karpova. - Janë objekte ushtarake të rrethimit të Moskës nga gjermanët.

Ato objekte monstruoze lufte i ngjallën trishtim Ernestit, me ato forma të vjetra të një kohe të egër, të paarsyeshme.

- Unë i humba të dy prindërit në rrethimin e Moskës. Më vdiqën të dy, nga uria. Unë shpëtova. Më shpëtoi Ushtria e

Kuqe. Ne, rusët, kemi vuajtur shumë për Europën, - tha ajo me një ton të indinjuar...

Po binte mbrëmja.

Para tyre, në qiellin e ulët shkëlqente refleksi i dritave të ndezura të Moskës.

Kaluan nëpër Kremlinin e ndriçuar mrekullisht dhe më pas u futën në një rrugë buzë lumit Vollga.

Befas makina bëri një kthesë dhe ndaloi në një shesh të bukur.

- Ky është hoteli yt për sonte... Nesër në orën 11:00 do të fluturosh për në Çeboksari. Fli mirë dhe kujdesu për veten, - i tha prerë Madamë Karpova dhe e puthi lehtë në faqe. - Në mëngjes nga ora tetë e gjysmë do të vij të të shoqëroj në aeroport. Kujdes zërin, - la ajo porosinë e fundit dhe u tret me dritat e rrugës diku nëpër natën e ftohtë...

- Mirë se vini, zotëri! - iu afrua portieri i hotelit Ernestit dhe pa e pyetur ia mori valixhen nga duart.

U fut në dhomën e ngrohtë dhe luksoze dhe mori frymë thellë...

U shtri me shpinë në krevatin e madh dhe nga mendja nuk i shqitej fytyra e bukur e Ludmilla Karpovës... Imagjinoi Çajkovskin apo Eseninin në vend të tij...

Vallë, ç'krijime magjike mund t'i kushtonin kësaj gruaje të mrekullueshme?

Me ato mendime u ngrit, hapi perdet e rënda dhe befas dalloi se dhoma e tij binte përballë Vollgës, pamjen magjepsëse të së cilës, ai mund ta sodiste nga afër.

U tundua nga ai ballkon i madh i dhomës së tij dhe vendosi ta sfidonte të ftohtin e acartë dhe ngricën që ia

skuqte fytyrën. Doli jashtë dhe po sodiste ca të rinj që po bënëin patinazh mbi lumin e ngrirë. Ndriçimi i rrugës ishte aq i mrekullueshëm sa dukej si një skenë e vërtetë, një pistë e ndriçuar sportive ku bëheshin gara të mirorganizuara.

Për një moment i pati zili ata të rinj të lumtur moskovitë, që po shijonin mbrëmjen e bardhë, mbështjellë me arin e dritave dhe perlave të shndritshme, të ngrira të borës.

Të qeshurat dhe thirrjet e tyre të lumtura thyenin ajrin e ngrirë të natës.

Ernesti u fut brenda dhe vendosi të bënte një dush të nxehtë...

Por në fillim hapi një shampanjë dhe as vetë nuk e kuptoi pse i erdhi të ngrinte një doli:

Nazdarovje Ludmilla Karpova dhe gjithë vajzat e bukura ruse, uroi ai me zë...

Pas dushit dhe pasi e boshatisi shishen e shampanjës e zuri gjumi thellë, i lodhur edhe nga udhëtimi i gjatë...

Papritmas u zgjua nga zilja e telefonit. Kokën e kishte të rënduar nga shampanja e darkës, por u kthjellua kur dëgjoi zërin kumbues të Ludmillës!

- Mirëmëngjesi, - e përshëndeti ajo.

E kuptoi se kishte fjetur pa u përmendur fare dhe se kish ardhur ora e zgjimit. Papritmas e kapi një panik se mos ishte vonë. Por Ludmilla Karpova sikur ta kish kuptuar nga ana tjetër e telefonit e qetësoi.

- Mos u bëj merak. Sot avioni është anuluar se ka stuhi në Çeboksari...

Por do të udhëtosh me një tren me kabinë personale. Do të jetë bukur dhe rruga zgjat vetëm 12 orë. Për një orë do të vij të të marr. Treni niset në mesditë.

Pasi pinë kafe dhe hëngrën një mëngjes të lehtë me biskota dhe mjaltë, Ernesti u gjet në stacionin e stërmadh të Moskës, që më së shumti i ngjante një galerie artesh. Muret e vizatuara, llambadarët gjigantë dhe harqet klasike të tavaneve, të pikturuara në stilin e renesancës, i jepnin një hije të rëndë me gjithë zhurmën që shkaktonin zërat e njerëzve të panumërt. Ernestit s’i kishin zënë sytë kurrë një stacion kaq të madh si ky. Pasi kërkuan për pak kohë binarin e duhur të trenit për në Çeboksari, më në fund Ernesti u fut në kabinën e tij.

Madamë Karpova e shoqëroi derisa u siguroi se kabina ishte e duhura.

Pasi i la disa porosi kujdestarit të vagonit dhe pasi u përshëndet duke e përqaftuar Ernestin zbriti gjithë finesë, duke lënë pas mahnitjen e tij dhe aromën e një parfumi të lehtë, por luksoz...

Ernesti mori frymë lehtë dhe e shoqëroi me sy derisa ajo u tret në turmën pa fund të njerëzve...

Ishte dhjetor dhe kurrë nuk e kishte menduar se një ditë, si në tregimet e Çehovit apo vargjet e Eseninit, do të çante mes për mes stepave të ngrira...

“Nën hije bjerozash me zhurmë”, iu kujtua një varg i poetit të madh...

U ul pranë dritares së madhe të veshur me avull dhe u shtri duke u rehatuar në kolltukun e bollshëm.

Jashtë kishte filluar bora, fjollëzat e mëdha të së cilës silleshin rrotull nga era e fortë si një grup balerinash në skenën e baletit *Liqeni i Mjellmave*.

E bukur, por e frikshme mendoj...

Papritur treni lëvizi dhe filloi të marrë shpejtësi...

Moska po zhvendosej me shpejtësi para tij.

Një qytet me konture të mëdha gri që tymoste si në një përgjumje kozmike.

Papritur u ndje larg, i vetmuar. Iu duk vetja si një udhëtar që kish humbur rrugën në një botë të frikshme, të bardhë, të ftohtë, të ngrirë, stepash...

Befas pamjet e ndërtesave të qytetit zunë të rralloheshin derisa humbën fare në bardhësinë e horizontit.

Treni ishte futur në zonën e stepave. Syri të zinte vetëm pemë dhe fusha të ngrira si në një botë fantazmash. Rrallë në atë bardhësi si të vdekjes shfaqej dhe zhdukej me të shpejtë ndonjë shtëpi fshati e vetmuar prej druri, që nxirrte nga oxhaku tym të zi, si për të sinjalizuar se aty kishte jetë.

Papritmas dera trokiti.

- Hyr, - u përgjigj Ernesti në anglisht.

Ishte një burrë i madh, me mjekër të kuqe që i mbajti një ligjëratë të pakuptueshme në rusisht.

“Tamam muzhik”, mendoi Ernesti.

- Ja nje znaju paruski¹, - iu përgjigj si i zënë në faj.

- Ah, - iu përgjigj rusi me buzë në gaz. - Adin moment², - dhe u largua.

Pas pak ai erdhi me një person tjetër, që e përshëndeti me një anglishte të çalë, por i kënaqur që mund të komunikonte me një të huaj dhe të futej në botën e një të panjohuri, ndryshe nga miku i tij që s’dinte asnjë fjalë përveç rusishtes.

¹ Unë nuk di rusisht.

² Një minutë.

- Kontrollori kërkon të kontrollojë biletën dhe dëshiron të të pyesë nëse do të porosisni për të ngrënë, apo për të pirë diçka...

- Patjetër, - iu përgjigj Ernesti dhe i nxori biletën. - Sa për të ngrënë, a mund të më sillni menynë? - iu drejtua “përkthyesit”.

- Unë jam Aliosha, - i zgjati dorën duke u prezantuar ky i fundit.

Pas pak, pasi kontrollori dhe përkthyesi komunikuan me njëri-tjetrin në rusisht dolën; për t’u kthyer përsëri i vetëm Aliosha me një meny në rusisht në duar.

- Këtu ka plot ushqime që gatohen në restorantin e trenit... Ndjesë se e kam të vështirë t’i përkthej, - u zu ngushtë ai.

- Mos u bëj merak,- iu përgjigj Ernesti. - Shpresoj të gjejme diçka të shijshme.

- Nga jeni, - e pyeti papritmas Aliosha i ngazëllyer që më së fundmi gjeti një mënyrë që mund t’i sugjeronte një ushqim që të përkonte me origjinën e udhëtarit të huaj.

- Shqiptar, - iu përgjigj menjëherë Ernesti...

- Çfarë?

Papritmas sytë e Alioshës mbetën të hapur nga diçka e pakuptueshme që e tronditi...

- Çfarë? - përsëriti dhe fytyra iu zbardh. - Shqiptar? - pëshpëriti përsëri me një zë gati të shuar... papritur ndjeu t’i këputeshin gjunjët dhe u ul...

- Më fal, - iu drejtua Ernestit, - s’kam asgjë me ty...

Ernesti po e shikonte i çuditur pa kuptuar asgjë. Treni çante me shpejtësi hapësirën e ngrirë dhe stepat tashmë i ngjanin një dekori të dhimbshëm që pasqyrohej në fytyrën e trishtuar të Alioshës.

- Më thuaj, - i foli me të butë Ernesti...

- Ti je gjaku im, - iu drejtua befas Aliosha... - Unë kam gjak shqiptar, e përforcoi zërin dhe i dha vetes forcë të rrinte ndenjtur pa u mbështetur...

- S'po të kuptoj, - iu kthye Ernesti...

Papritur Alioshës i rrodhën lotët.

I zuri dorën Ernestit dhe ia shtrëngoi me forcë.

- Po, ne jemi të një gjaku... S'e mendoja kurrë se do të ndodhte një ditë kështu...

Papritmas vuri kryet mes gjunjëve dhe nisi të qajë...

Ernesti hodhi sytë përtej xhamit të ngrirë të dritares.

Degët e përkulura të mështeknavë i dukeshin sikur ishin rënduar nga një dhimbje e madhe përtej të ftohtit.

- Ç'ka ndodhur, - e pyeti me gjysmë zëri dhe i vuri dorën me dhimbje në sup...

- Ka shumë vite... s'e kam njohur kurrë, - zuri të qante me ngashërim Aliosha... - Ai iku e na la të dyve... kam vetëm një fotografi të tij... Duket i bukur, i qeshur... Na braktisi pa kthyer kurrë kryet pas. Unë s'u mësova kurrë pa atë, megjithëse nuk e njoha kurrë. Isha vetëm një vjeç kur na la. Nëna ime, që e deshi aq shumë, nuk u martua kurrë dhe më mësoi ta dua dhe ta pres. Ajo ende beson se ai jeton, se nuk e ka harruar dhe se një ditë do të kthehet tek ajo, te mua, biri i tij. Unë jam shqiptar!

Ernestit s'po i besohej e gjitha kjo!

S'po e kuptonte plotësisht Alioshën dhe historinë e tij që dukej si një braktisje klasike, ikje pa kthim...

- Jo, jo. Ata duheshin dhe u lidhën me synim që të krijonin familje përjetë, - ndërhyri Aliosha sikur ta kishte kuptuar paqartësinë e Ernestit. - Të lutem, më ndihmo ta

gjej babanë tim, - iu drejtua papritur Aliosha Ernestit, i cili u shtang nga kjo kërkesë e beftë e bashkëbiseduesit. - Ai gjendet në Shqipëri. Ka studiuar mjekësi në Moskë... Është doktor kardiolog...

- Çfarë? - iu mbajt goja Ernestit. - Çfarë? - Zemra zuri t'i rrihte me shpejtësi dhe fryma gati po i zihej! - Je i sigurt? Si quhej? Ia di emrin? - e pyeti me ngulm dhe kërshëri Ernesti.

- Natyrisht, ia di... është babai im! Kam një jetë që dua ta takoj...

Befas Ernesti ndjeu një këputje...

Para syve po i shfaqej i ati dhe vargjet e Eseninut që ai gjithmonë i recitonte me trishtim...

Mbaj mend kur më thoshe po treten,

Dhe netët e kaltra o shpirt.

Por ti do të duash një tjetër,

Dhe s'do të më kujtosh më një ditë..."

Në grykë ndjeu një lëmsh që s'po e kapërdinte dot...

I ati i tregonte për aktin kriminal të diktaturës komuniste, që kishte ndarë shumë çifte studentësh shqiptarë, të cilët ishin lidhur apo martuar me vajza ruse. Të paktë kishin qenë ato që i kishin shpëtuar tragjedisë së dashurisë së tyre.

"Baba, s'të kam kuptuar deri më sot!", mendoi si i zënë në faj Ernesti dhe nga sytë i shpëtuan lotët.

Aliosha sikur e mori veten, por u çudit tek i pa lot në sy...

- Ç'ke, - deshi ta pyeste Ernestin.

- Po, - iu përgjigj Ernesti dhe iu hodh në qafë teksa po e përqafohte me dënësë...

- Babai yt dhe i imi është Bernardi... Vëllai im i mirë...

- Si, çfarë?!

Alioshës iu mbajt goja.

- Çfarë? Bernardi babai yt? Pra, ne jemi vëllezër...?

Mështeknat në stepa e kishin përkulur trupin akoma më shumë nga bora e dendur që s'të linte të shikoje më asgjë..

Si sytë e zënë nga perdet e lotëve...

Vështirë ta besonte dikush në atë tren se ç'kishte ndodhur!

Aq shumë ishte ngarkuar me mall dhe lot ai udhëtim përmes stepave, në zemër të Rusisë, atë dhjetor!

Sirena e trenit i ngjante një klithme të zvargur si vargjet e trishta të Esenininit:

Mbaj mend kur më thoshe po treten,

Dhe netët e kaltra o shpirt.

Por ti do të duash një tjetër,

Dhe s'do të më kujtosh më një ditë...

Ata të dy kishin mbetur të përqafuar në atë udhëtim të bardhë stepash që dukej i pafund.

Si një pafundësi malli dhe dhimbjeje...

ORAKULLI

Quhej Ben Karamelja, por askush nuk e dinte nëse Karamelja ishte vërtet mbiemri i tij, apo një nofkë.

Ishte një burrë i shkurtër, me nofulla të gjera dhe syze optike me numër të madh, që e bënë disi qesharak dhe që ndoshta i shkonte mbiemrit të tij.

Beni kishte ndërtuar rreth vetes një mister që e bënte atë gjithashtu të veçantë.

Besonte se përcaktonte fatet e njerëzve nga ngjyra e syve.

Kaq shumë kishte marrë dhenë fama e tij sa ai përveç punës së tij të përditshme si mekanik, në një servis makinash, kishte hapur edhe një zyrë.

Njerëzit vinin nga të gjitha anët për të mësuar fatin e tyre.

Dhe ishte e çuditshme që Ben Karamelja në vend t'i ëmbëltonte i kthente njerëzit shpesh të mërëzitur me parashikime jo të lumtura.

Askush nuk e dinte, madje as ai vetë, se nga i kish ardhur dhe si i ishte shfaqur ajo dhunti Ben Karameles. Ai thoshte se një herë, kur kishte qenë i ri, i ishte shfaqur një plak që e kishte prekur në kokë dhe i kish thënë: ti do të bëhesh parashikues i botës!

Por Ben Karamelja kishte dështuar në parashikimet e mëdha për botën.

Parashikimi për një luftë botërore apo për fundin e botës e kishin bërë atë pothuajse qesharak në sytë e njerëzve.

Prandaj ai nuk merrej më me parashikime të mëdha, por tani merrej me parashikime fejesash, udhëtimesh, ndarjesh, lindjesh, gjëra pa zarar dhe nga ato që harrohen shpejt në jetën e përditshme të njerëzve.

Ben Karamelja atë ditë nëntori ndiente se vërtet kishte fuqi të jashtëzakonshme dhe dhunti që e bënin atë të veçantë.

I kishte ardhur një ide se mund të dallonte fatin e njerëzve jo vetëm nga ngjyra e syve, por edhe nga forma e duarve, që ai kishte vënë re se duart dallonin në njerëz të ndryshëm.

Ndihej pothuaj i ekzaltuar nga ky zbulim i ri dhe vendosi ta aplikonte po atë ditë.

Në pritje ishin grumbulluar 5-6 vetë.

Pasi u pa retinat misterioze të syve dhe lexoi të dhënat prej tyre, u kërkoi t'u shihte format e duarve.

Çuditërisht rrjedhshëm filloi t'u lexonte fatin.

Madje njërit i lexoi se nusja e djalit i kishte mbetur shtatzënë me një djalë.

Kaq e madhe ishte çudia sepse djali i personit ishte i vogël në moshë dhe s'ishte martuar ende; Ben Karamelja e bindi se parashikimi s'ka kohë.

Ai i vjen dhe shumë vite përpara, që do të thoshte se i biri do të martohej dhe do të kishte djalë!

Parashikimi me duar iu duk më i prekshëm, më i saktë. Në fund të fundit duart flisnin, komunikonin, ishin pjesë e ekspresionit njerëzor.

Personi i fundit për atë ditë do ta befasonte Ben Karamelen dhe do ta bënte të ndihej Zot i vërtetë!

Njeriu që kishte përpara s'kish ardhur të shihte fatin, por ta falënderonte.

Para një viti Beni i kish parë fatin dhe i kishte thënë se gruaja ishte e sëmurë rëndë, por do t'i shërohej. Vërtet mrekullia kishte ndodhur. E shoqja ishte shëruar. Madje, sipas pohimeve të vetë personit, Beni i kishte gjetur edhe se operacioni i parë do t'i dilte pa sukses, i dyti me sukses dhe se mjeku do të ndërrohej. I kishte thënë dhe orën se kur do të shërohej dhe ditën kur do të ngrihej në këmbë.

Ben Karamelja ishte shastisur dhe s'po u besonte veshëve.

Të ish ai autori i këtyre mrekullive?

Po i dukej vetja si Zoti, por pa me frikë nga personi.

Mos ndoshta ai po tallej?

Por jo. Ai ishte aty para tij duke i atribuar shërimin e gruas dhe parashikimin gjenial të Ben Karameles, i cili po ndiente se fuqia e tij mbinjerëzore ishte sa e saktë aq dhe e prekshme.

Befas ndjeu se ideja për të parathënë fatin me anë të duarve ishte dhuntia që vetë Zoti ia kishte bërë dhuratë së fundmi...

Që nga ajo kohë historia e Ben Karameles mori dhenë dhe njerëzit dyndeshin për të parë fatin e tyre gjithë shpresë dhe bindje të verbër...

PRINCI I KALTËR

Ana i kishte mbushur të dyzetat dhe kishte kohë që kishte hequr dorë nga martesat.

Vitet i kishin ikur pa kuptuar dhe tani askush s'kujtohej më për të.

Ishte ende e bukur, me trup të mbajtur mirë, por flokët kishin filluar t'i thinjeshin dhe t'i humbitnin atë shkëlqimin e rinisë.

Jetonte e vetme dhe pothuaj e llastuar me vetminë e saj.

Përveç kohës së punës si edukatore, ditën ia kushtonte vetes. Merrej me vrap, gjimnastikë dhe vishej bukur.

Por darkave futej e tëra në botën e saj. Ndiqte *facebook*-un, *instagram*-in dhe futej në *chat*.

Në një nga sitet kishte njohur një person.

Ai i ishte shfaqur si engjëll. Nuk e kishte takuar ende, por po priste me padurim ta shihte. Alfredi i kishte thënë se ishte inxhinier. Nga fotot, që i kishte dërguar, dukej king dhe i mbajtur. Ishte rreth të dyzetave.

Ishte kohë darke dhe rreth orës nëntë Alfredi futej në *chat*.

Dhe ky ishte momenti i një lumturie të papërshkruar për Anën.

Ai futej dhe i sillte nga ana tjetër e *chat*-it dashuri, siguri, ia përkëdhelte ëndrrat. E bënte të ndihej e pamoshë ose si

një 18-vjeçare. Ai ishte tamam Princi i kaltër që ëndërron çdo grua.

Ana kishte rënë në dashuri keqas me të, por e përmbante veten. Megjithëse kishte ngurruar për një kohë të gjatë, më në fund kishte vendosur ta quante Princi i kaltër. Alfredi ndihej i lumtur nga kjo përkëdhelje dhe kish nisur ta quante si për t'i larë borxhin, Borëbardha. Por çuditërisht ky emër Anën nuk e bënte të ndihej e lumtur. Kishte diçka tragjike në fatin e Borëbardhës që nuk i pëlqente. Sa herë që ai e thërriste kështu Anën, asaj i dukej diçka e kotë dhe sipas saj ai përpiqej ta bënte të ndihej mirë, por në të vërtetë pa efekt.

“Zemër, si je?”, Alfredi po i shkruante nga ana tjetër e *chat-it*.

“Mirë zemër! Po ti? - iu përgjigj ajo. - Si ke kaluar sot...?”

“Mirë... po nga ti ç'kemi?”

“Ndihem e mërzhitur, - iu shpreh ajo. - U bënë kaq kohë që flasim dhe ende s'të kam parë!!!”

“O Zot, përsëri e njëjta histori. Më ke parë, zemër. I ke fotot e mia... pse bën kështu?”

“S'të kuptoj! Ç'të pengon të më takosh?”

“Asgjë! Vetëm ndihem i pasigurt. Nuk ndihem gati... kam shumë emocion zemër...”

“S'të besoj! Kjo më duket e tepërt!”

“Të betohem! Kam kaq shumë emocione kur flas me ty... lëre të të takoj. Do ta them vetë se kur do të shihemi...”

“Jo, jo. Dua sonte...”

“Je në vete... ç'ke kështu?”

“Asgjë! Por s'më bind dot!”

Ajo vendosi papritur që ai të vinte e ta takonte. Nuk e shtynte dot më pa e parë njeriun që aq shumë e donte... të cilit kishte vendosur t'i jepej.

“Do vish sonte ose...”, ajo pati frikë t'ia thoshte se s'do ta takonte më dhe do t'i jepte fund lojës.

“Nuk vij dot...”

“Përse?”

Debati midis tyre po thellohej duke treguar, në të njëjtën kohë, sa e cekët ishte lidhja midis tyre.

“Do të vish sonte!”, i dha urdhër ajo.

"Hmmm!", bëri një pauzë.

Ajo i shkroi dhe një herë adresën.

“Kur po vjen?”

“S'e di”, iu përgjigj ai.

“Më thuaj një kohë!”

“Në dhjetë”, i shkroi ai.

E mbyllën *chat-in*! Anës po i rrihte zemra me vrull. U pendua që i kërkoi të vinte. Ndjeu se as ajo nuk ishte gati ta takonte.

Bëri një dush të shpejtë dhe mbi gjoksin e fryrë veshi një bluzë të lehtë mëndafshi që e nxirrte shumë seksi.

Ora po i afrohej dhjetës. Ajo ndjeu se po i rrihte zemra më fort. Mbylli sytë dhe mendoi puthjen e tij. Një zjarr i brendshëm e përfshiu dhe ndjeu nevojën mashkullore të tij.

Erdhi ora dhjetë.

Ajo zgjati veshët të dëgjonte zilen e derës. Por heshtje.

Sa u vonua, tha ajo me vete kur ora shkoi dhjetë e një çerek. Gjithmonë pritjet me padurim zgjasin më shumë, mendoi.

Shkoi dhjetë e gjysmë.

Atë e zuri vaji.

Princi i kaltër po i zhdukej kaq papritur saqë ajo s'e kishte menduar. Ishte një ndjesi e tmerrshme boshllëku. Nga ato boshllëqe që duket se nuk i mbush dot asgjë.

Ajo qau gjatë atë natë për Princin e saj, që iu zhduk aq lehtësisht nga jeta dhe aq pa mëshirë.

E PËRDALA

Ajo ka qenë femra e parë, që kam njohur si të përdalë, në jetën time.

Isha i ri dhe në qytetin tonë të vogël, që gumëzhinte nga thashethemet që përbënin lajmet kryesore, me të cilat argëtoheshin dhe shtynin ditët e varfra njerëzit, kjo ishte hera e parë që shihja një kuçkë të vërtetë siç i thoshim ne një femre pa moral.

Kisha dëgjuar histori me gra të liga, gra që kishin tradhtuar burrat dhe ishin zënë mat me dashnorët e tyre, por Marjeta ia kalonte të gjithave.

Jo vetëm se ishte aq e bukur, por sepse nuk donte t'ia dinte për askënd dhe për asgjë.

Vishej bukur, me ngjyra të ndezura dhe me fustane të prera bukur dhe të ngushta, që i nxirrnin në pah qafën dhe gjoksin e bukur, të lëshuar. Por mbi të gjitha i tregonin belin e ngushtë epshndjellës dhe të pasmet e mbushura.

Të gjithë meshkujt, kur kalonte ajo në rrugë, kthenin kokën dhe e ndiqnin me sy.

Dikush lëshonte edhe ndonjë pasthirrmë mashkullore apo ndonjë fjalë për ta ngacmuar.

Por Marjeta jo vetëm që nuk skuqej dhe nuk ndihej keq, por përkundrazi ajo ngrinte kokën lart dhe u hidhte vështrime provokuese duke buzëqeshur me çapëkëllëk.

Jo pak meshkuj kishin rënë pre e bukurisë dhe e sjelljes së saj.

Flitej se rreth shtëpisë së saj silleshin jo vetëm djem të rinj e të pashëm, por dhe burra të martuar.

Marjeta i sillte rrotull shumicën e tyre, por ndonjëri qëllonte dhe me fat...

Midis atyre që e adhuronin Marjetën isha dhe unë...

Jo thjesht si femër, por më shumë si karakter.

Më tërhiqte natyrshmëria e saj, kuraja për të pranuar veten ashtu siç ishte dhe forca që kishte në atë paraqitje të brishtë femërore për të përballuar opinionin e një qyteti që e konsideronte si të përdalë.

Kishte një bukuri mahnitëse, të cilën ia shtonte edhe makijazhi i veçantë; përdorte të kuq buzësh të ndezur, që nuk ishte zakon i vajzave beqare, rimel në qerpikët e dendur e të gjatë dhe vetullat i kishte të hequra e të ngritura.

Më magjepste pamja e saj dhe krenaria që i shfaqej në ato vetullat e ngritura dhe në atë shikimin moskokëçarës.

Një buzëmbremje, teksa isha duke kaluar në rrugicën e saj, pranë kinemasë verore të qytetit, për pak desh u përplasëm me njëri-tjetrin.

Po afrohej nata dhe në rrugë s'kishte njeri.

Tek e pashë ashtu aq të bukur përballë meje u shtanga.

Mund të isha 16 ose 17 vjeç...

“Ç’ më shikon ashtu si buf? S’ke parë femër me sy? Me libra do të flesh gjithë jetën ti?”

Doli se ajo më njihte.

Pastaj m’u afrua dhe më hodhi dorën në qafë duke më tërhequr me forcë nga vetja.

Pastaj sa hap e mbyll sytë më puthi gjithë afsh në buzë!
“ Hmmm, - mëmëriti ajo, - ke buzë të mira.”

Ndjeva një aromë parfumi dhe gjuhën e saj thellë në gojën time dhe u çudita...

S’kisha puthur kurrë më parë dhe s’e mendoja kurrë puthjen kështu... tamam puthje kurve mendova dhe më erdhi ndot nga vetja.

Je i pamësuar, tha ajo kur pa se unë kisha shtangur. Duhet të fitosh ca përvojë dhe më lëshoi duke u larguar me hapa të lehtë. U zhduk në rrugicën me plepa dhe selvi, hija e të cilave e bënë muzgun më të errët.

Atë natë s’më zuri gjumi. Më vinte turp nga vetja, që më kishte puthur një kurvë si Marjeta, por ndieja dhe njëfarë krenarie mashkullore se isha burrëruar dhe kisha provuar një puthje femre...

S’më shqitej nga mendja puthja e saj dhe Marjeta me sharmin e saj femëror aq të spikatur...

Kaluan muaj dhe një ditë ndodhi diçka që s’do ta harroj kurrë...

Teksa bënim shëtitjen e mbrëmjes, në bulevardin e vetëm të qytetit, me një shokun tim të fëmijërisë, nga ana tjetër e trotuarit dëgjoheshin ca klithma grash.

Ishte mbledhur një grumbull njerëzish kureshtarë, që po rritej, që po sodisnin një sherr të saponisur grash.

U afruam dhe ne, por jo shumë pranë...

U trondita kur pashë Marjetën e bukur, të cilën e kishte kapur për krahu një grua shpatullgjerë dhe e egërsuar në kulm.

“Kurvë!” - i bërtiste gruaja e zemëruar në fytyrë Marjetës që s’dinte nga t’i hidhte sytë nga poshtërimi.

“Lëre burrin tim në punë të vet se është baba fëmijësh...”
Kurvë, vazhdonte t’i ulërinte gruaja në fytyrë dhe befasiu hodh përsipër duke e zënë për flokësh...

Njerëzit rrotull, që po argëtoheshin nga kjo skenë mizore, zunë të qeshnin...

“Ouuu!”, thirri nga dhimbja Marjeta.

Më theri në shpirt ajo piskamë e dhimbshme.

Marjeta ngriti duart dhe u mundua t’ia hiqte duart nga flokët gruas së inatosur, që po ia tërhiqte pa mëshirë.

Papritur gruaja u rrëzua dhe u ngrit më e egërsuar...

“Kurvë, si guxon të më marrësh burrin, babanë e fëmijëve të mi dhe të vësh dorë mbi mua...”

Papritur një djalë i ri, siç duket i biri iu turr Marjetës me një egërsi jashtë çdo kontrolli dhe e qëllloi me grusht në fytyrë.

Befasi Marjeta u trondit dhe u rrëzua. I riu si një egërsirë filloi ta shkëlmonte në trup, brinjëve...

Marjeta mudohej të mbronte veten duke u mbuluar me duar.

Pas çdo goditje të tij më dukej sikur po më godiste dikush me një thikë në gjoks.

S’durova më dhe u sula t’i dilja zot asaj femre që po dhunohej në sy të njerëzve kaq barbarisht. Por shoku im më doli përpara dhe s’po kuptonte se ç’doja të bëja...

“Ke luajt mendsh? Do t’i dalësh zot një kurve?”, filloi të më fliste ai në fytyrë duke më zmbropsur.

Pashë Marjetën që i ishte nxirë njëri sy dhe nga hundët i kishte shpërthyer gjaku... s’do ta harroj kurrë atë pamje aq të trishtë.

“Kurvë, hiq dorë nga burri im”, thërriste gruaja e inatosur teksa dikush e tërhiqte larg skenës së sherrit.

I biri e kishte zënë për dore.

Ndërkohë që Marjeta e shtrirë kishte larë rrugën me gjak.

Befas sytë m’u përplotën. Trupi i asaj gruaje të bukur, që kishte guxuar të ndiqte zjarrin e instinkteve të saj, dukej si një akuzë mbi qytetin që fshihte poshtërsinë dhe fajësonte për gjithçka një grua dhe vinte dorë mbi brishtësinë e saj për të larë veten...

S’doja ta besoja që do ta shihja Marjetën krenare ashtu të shtrirë dhe të dhunuar aq barbarisht në rrugë!

Pas pak dikush kishte thirrur ambulancën e vetme të qytetit.

Titi, shoferi, e mori në krahë dhe e vuri në krevatin portativ të ambulancës. Pastaj me shpejtësi vetëtime, siç dinte të ngiste makinën vetëm Titi, shkoi në urgjencën e vjetër të qytetit.

Kjo ishte hera e fundit që e pashë Marjetën.

Siç duket u mbyll brenda në shtëpi dhe s’doli më kurrë.

Pas disa kohësh mora vesh se ishte martuar në Tiranë dhe se ishte bërë grua për shtëpi dhe një nënë e mirë!

Gjithsesi ishte dhe mbeti në kujtesën time dhe në historinë e qytetit tonë të vogël si kurtizania e parë...

LETRA E FUNDIT

“E dashura ime!

Po të dërgoj këtë letër të fundit...

Të fundit me penë dhe nga dora ime, me shkronja dhe letër të bardhë.

Por shpirti im do të të dërgojë pa postë letra çdo ditë, derisa të jem gjallë.

Sonte bie shi dhe dimri me egërsinë e tij më ka zënë në këtë dhomë të ftohtë që përpiqem ta ngroh me frymën time dhe me furnelën e vogël elektrike.

Qielli ka ditë që po zbraz pa pushim zemërimin e tij inatçor.

Shi dhe vetëtima që sikur çajjnë shpirtin tim!

U bë kohë që ti s’më shkruan më, nuk pranon thirrjet e mia të të shoh.

Pavarësisht se çfarë thua, unë e di mirë se çfarë të ndalon të më duash.

Unë jam i varfër!

Unë s’të blej dot trëndafila sa herë të takoj, s’të bëj dot dhurata që të gëzojnë si fëmijë...

Por ti s’më beson se unë dua të ta mbush botën me trëndafila; kudo ku ti shkel dhe derisa syri yt mund të shikojë. Se dua të të shoh si princeshën e botës.

Ti e di se unë të dua, por ti s’e di sa shumë të dua.

Se dashurinë ti s'e mat me shpirtin, por me xhepat e mi.

Ti s'e di, që unë besoj, se ky dimër i egër është zemëruar me ty.

Se ky dimër po të qorton ty dhe gjithë këtë botë që mendon dhe gjykon si ti.

Unë besoj se nuk është shi, por qiejt që qajnë me lot dhimbjen time.

Unë jam i varfër, por ty të dua.

Unë s'jam i varfër sepse nuk jam i zoti, por se nuk kam një mundësi të punoj, megjithëse kreu universitetin me nota të shkëlqyera dhe jam i zoti në profesionin tim.

Por unë nuk kam një dorë të më afrojë, të më japë një shans.

Mendova se të kisha ty pasurinë time, mbështetjen e vërtetë.

Por ti ma largove dorën që ma dhe kur ishim të rinj, plot ëndrra dashurie dhe zgjodhe këtë natë të errët për të më lënë kaq të vetmuar.

Ti dole nga jeta ime me kaq dhimbje, me një qiell kaq të trishtuar dhe të zemëruar, me kaq shumë shi dhe vetëtima.

Kjo është letra e fundit për ty.

Por kurrë e fundit në zemrën time.

Unë ty të desha mbi gjithçka në këtë botë.

Dhe do të të dua derisa ta kuptoj se çdo gjë në këtë botë lind dhe vdes; se ka një ditë që fillon dhe një ditë kur gjithçka mbaron.

Nuk doja ta besoja kurrë se ti s' do të besoje në dashurinë time, por në atë që unë s'jam i zoti të të ofroj; pasurinë.

Sonte po ndahemi me shi e vetëtima, megjithëse u deshëm dhe u puthëm në parqe plot lule dhe u dehëm me

aromat e tyre. Ndoqëm zogjtë dhe u përpoqëm të fluturonim nga lumturia pranë njëri-tjetrit bashkë me ta.

Mbyllëm sytë dhe ëndërruam një jetë bashkë përpara...

Sonte përpiqem të dalloj diçka në terrin e natës, por e kam të pamundur.

Kumbulla e vjetër, ku u puthëm për herë të parë, me siguri duhet të jetë duke u dridhur e gjitha nën forcën e erës dhe të shiut të rrëmbyeshëm.

Më vjen keq për atë kumbull, që na hodhi polenin mbi buzë dhe na parfumosi, tek i premtonim njëri-tjetrit dashuri të përjetshme nën puthjet e zjarrta.

Unë ty të kam dashur.

Unë të desha pa u lodhur kurrë, me gjithë forcat e mia, me gjithë pasurinë time: veten time!

Të desha aq sa kjo natë e pafundme, aq shumë sa ky shi, me aq zjarr sa të gjitha këto rrufe bashkë.

Teksa përpiqem të gjej fjalët e duhura të kësaj ndarje me ty mendja më shkon se ç'mund të të bëjë të lumtur ty, që më ktheve shpinën në një natë si kjo, që më hape këtë plagë të pamatë.

Megjithëse e ndiej dhe e kuptoj, përgjigjen e kësaj pyetjeje, s'dua ta besoj; s'dua asnjë njeri në këtë botë ta besojë se ka pasuri tjetër përveç dashurisë, përveç kësaj letre që ia kalon çdo çeku bankar!!!

Unë ty të dua.

Kaq duhet të mjaftonte që këto fjalë të të zgjonin dhe të ndriçonin arsyen tënde më shumë sesa këto vetëtimat që ndriçojnë natën e errët të këtij dimri me stuhi..."

Papritmas, ai hapi dritaren që të merrte frymë thellë dhe të çlirohej nga ajo dhimbje që e kish mbërthyer në gjoks.

Rrebeshi i shiut iu përplas mbi ballin e bukur dhe një pjesë e ballukeve të zeza ia mbuloi njërin sy...

Mori letrën me kujdes, që të mos ia zinte era e lagur, që hynte me forcë nga jashtë, dhe e futi në zarf..

U mbështet përsëri mbi parvazin e vjetër të dritares dhe me gjithë të ftohtin dhe furinë e shiut të ftohtë vazhdoi të qëndronte aty, për të lehtësuar disi dhimbjen e shpirtit.

Ashtu nëpër terr filloi të kërkonte me sy kumbullën e vjetër!

Befas një dritë verbuese i ra para fytyrës.

Ndjeu një dridhje dhe djegie të dhimbshme në supin e djathtë dhe ra pa ndjenja...

Por befas përjetoi një paqe të jashtëzakonshme, një puhizë pranverore që e përkëdheli dhe aromë lulësh që e bënë të lumtur.

Dhe papritmas, kur hapi sytë të shikonte mrekullinë që po e rrethonte, pa mbi veten fytyrën e saj të bukur.

Ndjeu një lumturi të parrëfyer dhe ashtu me sytë e mbyllur ndjeu puthjen e saj... U përhumbe përsëri nga lumturia dhe s'deshi të zgjohej më kurrë nga ajo ndjesi magjike.

“Zgjohu të lutem”, dikush po përpiqej ta ngrinte nga ai përjetim.

Befas njohu zërin e nënës.

S'donte të zgjohej, por pastaj tek dëgjonte lutjet e saj i hapi sytë me vështirësi. Në ballë i ranë ca pika loti.

Vështroi dhe u çudit me atë mjedis të çuditshëm ku ndodhej.

- Bir, - i thirri e ëma.

Ai hodhi sytë me kureshtje rrotull dhe vuri re se ndodhej në një dhomë spitali, rrethuar nga aparatet mjekësore.

- Ku ndodhem këtu?

- Bir, të ruajti Zoti, - iu përgjigj e ëma.

- Është gjithçka mirë, - i foli me zë të butë një mjek. - Të zuri rrufeja, por ishe me fat. Ti je i fortë dhe ia dole...

Atij iu kujtua drita verbuese para syve...

- Nënë, - iu drejtua befas së ëmës.

- Mos u bëj merak bir, - iu përgjigj e ëma menjëherë. - E kam këtu, - dhe i tregoi zarfin e mbyllur që e kishte me vete në çantë.

- Grise! - i tha së ëmës.

Deshi t'i thoshte se ndihej me fat që midis jetës dhe dashurisë fati i kishte zgjedhur jetën për të jetuar.

Tashmë kishte një jetë të dytë. Dhe duhej ta jetonte. Pati një dëshirë të ngrihej, por shpatulla e fashuar i dhembte.

“Kështu është kur ia hedh vdekjes, - mendoi. - Të dhembin plagët dhe përpiqesh të jetosh sa më gjatë, qoftë dhe me dhimbje.”

SHTRIGA

Gjithmonë shtrigave u jam trembur kur isha i vogël...

Nga përrallat e fëmijërisë shtrigat kanë zënë vend në imagjinatën time si krijesat më të frikshme të kësaj bote, jo vetëm nga imagjinata për pamjen e tyre, por mbi të gjitha nga shpirtligësia dhe personifikimi i së keqes.

Por kur u rrita disi më shumë, mendova se shtrigat ishin vetëm sajesa përrallash.

Derisa një ditë u binda se shtrigat nuk gjendeshin vetëm në tregimet e moçme, por dhe mes nesh, në jetën e vërtetë, reale.

Kjo është historia e dashurisë sime të parë.

Një nga ato histori që gjithkush e ka kaluar në adoleshencën apo në rininë e tij.

Unë u rrita në një qytet të vogël, buzë detit, në një shtëpi të thjeshtë, me libra, mes lulesh dhe pemësh, por dhe me ëndrra të mëdha për jetën dhe të ardhmen.

Si një djalë që i gdhija dhe i ngrysja ditët mbi libra, natyrisht që fillova të mendoja shpesh edhe kush do të ishte princesha e jetës sime.

Shihesha me kënaqësi çdo ditë para pasqyrës se si rritesha, hidhja shtat dhe bëhesha më i pashëm.

Vajzat më hidhnin sytë jo vetëm se vishesha me shije, por dhe se flisja e qeshja me shpirt.

Natyrisht, kjo po e shtonte edhe numrin e ziliqarëve të moshës sime.

Gjithsesi erdhi një ditë dhe papritur ndodhi ajo që e kisha imagjinuar si në një tregim librash.

Rashë në dashuri krejt papritur, por u duk që në fillim që nuk ishte fare ashtu siç kisha lexuar në librat e mi.

Një ditë, në një nga rrugët e pakta të qytetit tim të vogël, u ndesha me një vajzë të bukur, me ca sy që më shikuan me ngulm dhe çapënkllëk.

S'isha mësuar kurrë me një vështrim femëror të tillë që më errësoi shikimin dhe për pak çaste edhe më hutoi.

Teksa ajo vazhdoi rrugën ktheva kokën dhe e ndoqa me shikimin nga pas.

Kishte një trup të gjatë, flokë të drejtë, të shkurtër, ngjyrë gështenjë plot dritë dhe një bel të vogël që i jepte hijeshi si një balerinë.

Ecte me një hap të lehtë, por të vendosur si për të siguruar kalimtarët që i hidhnin sytë me admirim se s'donte t'ia dinte për shikimet e tyre dhe për askënd.

Ndjeva një trazim të fortë në shpirt dhe po mendoja se ç'mund të ishte gjithë kjo që po më ndodhte?

Ç'ishte ajo vajzë me atë shikim aq të guximshëm dhe aq mbresëlënës që më prishi qetësinë kaq papritur?

Të nesërmen u zgjova me sy të ënjtur dhe me mendimin të gjeja patjetër emrin dhe adresën e vajzës misterioze, që me atë ecje prej kryeneçeje dhe me shikimin e saj kureshtar më kishte lënë gjithë natën pa gjumë.

U enda prej disa orësh me shpresën ta shikoja përsëri në të njëjtën rrugë, por pa rezultat.

Vetëm kur vendosa të kthehesha në shtëpi, i dorëzuar nga mungesa e fatit, papritur takova Mirën, shoqen time të fëmijërisë, në lagjen e vjetër.

- Ç'bën këtej? Ke gjithë ditën që sorrollatesh, - më tha ajo sikur po hakërrehej.

U çudita nga toni i saj.

Me siguri do të kem rënë në sy për keq mendova.

- Hm, hiç, ja... - zura të shpjegohesha si i zënë në faj. - Po kërkoj një shok. Dua t'i marr një libër.

Isha vetëm 17 vjeç dhe Mira ishte femra e parë që më kishte afruar si mashkull.

Një ditë, në verën që sapo shkoi, më hodhi dorën në sup duke më vështruar drejt në sy, mu në mes të detit dhe për pak më puthi në buzë.

Unë iu shmanga duke u zhytur i turpëruar dhe si i zënë në faj, thellë në ujin e tejdukshëm të detit.

Që nga ajo kohë i druhesha Mirës dhe ndjenjës së saj për të m'u afruar. Ishte e bukur dhe e zgjuar, por më trembte me afrimin e saj dhe më krijonte një ndjesi pasigurie jo të mirë..

U ndava me Mirën, por thellë vetes ndieja sytë e trishtuar të saj që më ndiqnin me zhgënjim.

Të nesërmen dola përsëri me ndjenjën e një dëshire të disafishtë për të ndeshur vajzën e bukur, që më kishte prishur gjumin dhe më kishte ndezur ëndrrat.

Ecja si i hutuar, kur papritur para syve m'u shfaq Mira:

- Akoma këtej ti? Ç'të ka ndodhur që ecën kaq i hutuar? Mos ke rënë gjë në dashuri, ore rryp?

Ajo gjeti kurajën edhe të më fyente.

- Jo, - iu përgjigja i ndrojtur, - thjesht po eci pak.

Ndërkaq brenda po zieja dhe doja t'ia jepja një pëllëmbë syve. “Ç’më kujton kjo mua, skllav të saj?”

- Po kërkoj një vajzë, - më doli papritur kjo frazë, si një hakmarrje ndaj fyerjes së saj. - Kam rënë në dashuri me të, - ia plasa në fytyrë aq sa ajo shtangu dhe u skuq në fytyrë si spec i kuq.

- Ç’thua mo, vërtet? - belbëzoi ajo si e goditur. - Po kush është ajo që t’i paska marrë mendtë e kokës, - pyeti Mira sikur sapo të ishte zgjuar nga gjumi.

- As vetë s’e di! Por di që ajo femër më ka marrë gjumin, qetësinë, zemrën...

- Si kështu? Edhe pa e ditur se kush është?

E pashë si fajtor dhe pranova shikimin ironik të Mirës që po më shikonte si për mëshirë. “Budallai i shkretë”, thoshte Mira me shikimin e saj.

Mendo ç’të duash iu përgjigja me sytë e mi. Unë e dua atë, por jo ty.

Ajo më vuri dorën butë në sup si dikur në mes të detit dhe më tha:

- Mos u mërzit, se do ta gjesh! - foli dhe u shkëput sikur t’i kish hyrë një gjemb në këmbë.

Ishte vjeshtë dhe era i merrte gjethet e zverdhura me vrull.

Qielli i ngjante një peizazhi të ngjeshur me ngjyra dhe emocione. Diku dielli lëshonte rreze të forta e diku retë ngjyrë plumbi të ngjallnin trishtim.

Papritur Mira u largua dhe unë mbeta përsëri vetëm, por me gjoks të copëtuar nga një dhimbje e pakuptuar.

Sapo i kisha zbuluar sekretin e zemrës pikërisht njeriut që s’duhej dhe papritur ndjeva një urrejtje të pashpjeguar për Mirën dhe dashurinë e saj që më lodhte dhe më shqetësonte.